



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Kumtesë për media

17 maj 2021

RrGK në përkrahje të protestës për rastin e ngacmimit seksual ndaj të miturës

Duke përcjellur me shqetësim të madh rastin e ngacmimit seksual të një të miture nga tre djemë po ashtu të mitur, në shkollën fillore “Faik Konica” të Prishtinës, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) mbështet [protestën](#) e sotme të organizuar nga Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist, e cila mbahet tek Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me fillim nga ora 12:00.

Sado që dhuna me bazë gjinore është mjaft e shpeshtë edhe në mesin e të miturve, megjithatë ende ka mungesë të raportimit dhe trajtimit të rasteve në mënyrë të duhur. Andaj, RrGK bën thirrje që institucionet përgjegjëse ta trajtojnë këtë rast me prioritetin e duhur, ashtu siç do duhej të trajtohet edhe secili rast tjetër i ngacmimit dhe sulmit seksual. Me theks të veçantë, shkollat duhet urgjentisht të krijojnë mekanizma të cilët trajtojnë rastet e dhunës, ngacmimeve dhe sulmeve seksuale.

Kujtojmë se RrGK së fundmi ka publikuar raportin “[Nga Ligjet Vepra](#): në Monitorimi i reagimit institucional ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë”, ku për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit kemi rekomanduar:

- Të mbahen trajnime për edukatorët dhe psikologët për format e dhunës me bazë gjinore; si të identifikohen shenjat e dhunës me bazë gjinore; dhe si të ndihmon të referohen këtë raste.
- Të përfshihet materiali mësimor mbi barazinë midis grave dhe burrave, respektin e ndërsjellë, rolet gjinore jo stereotipike, dhunën me bazë gjinore dhe mënyrën e raportimit të tij në kurrikulat arsimore të përshtatshme për grupmosha të ndryshme, siç parashikohet nga Konventa e Stambollit.
- Të ndahet buxhet i mjaftueshëm për rritjen e numrit të psikologëve në shkolla.

Për fund, duhet përmendur se ashtu si për rastet e tjera të dhunës me bazë gjinore, RrGK do të kërkojë drejtësi dhe do të monitorojë nga afër këtë rast si dhe masat e ndërmarra për të.